

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga Telemah Slovenia d.o.o. (Telemach Slovenija d.o.o.), me seli në rrugën Brnçiçeva 49, SI-1231, Lublana-Çrnuçe, Slloveni, përmes Bozhidar Millosheviq, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 04.12.2023, solli

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga shoqëria Telemah Slovenia d.o.o. (Telemach Slovenija d.o.o.), me seli në rrugën Brnçiçeva 49, SI-1231, Lublana-Çrnuçe, Slloveni, mbi shoqërinë KTV DRAVOGRAD shoqëria për telekomunikacion d.o.o. (KTV DRAVOGRAD družba za telekomunikacije d.o.o.), me seli në Mezha 143, 2370 Dravograd, Slloveni dhe NAKOM shoqëria për informatikë dhe shërbime d.o.o. (NAKOM družba za informatiko in storive d.o.o.), me seli në Mariborska cesta 70, 2370 Dravograd, Slloveni, me anë të shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 17.03.2023, ndërsa e plotësuar më 28.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga shoqëria Telemah Slovenia d.o.o. me seli në rrugën Brnçiçeva 49, SI-1231, Lublana-Çrnuçe, Slloveni, ku Telemah Slovenia d.o.o. do të fitoj kontrollin e vetëm mbi shoqërinë KTV DRAVOGRAD shoqëria për telekomunikacion d.o.o.), me seli në

Mezha 143, 2370 Dravograd, Slloveni dhe NAKOM shoqëria për informatikë dhe shërbime d.o.o. , me seli në Mariborska cesta 70, 2370 Dravograd, Slloveni, me anë të shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

**Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**Telemah Slovenia d.o.o.** është në pronësi të plotë të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimi ndërkombëtar me qendër në Londër. Fondet e BC janë ekskluzivisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshirë në aktivitetet e përditshme të biznesit të kompanive ku investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners është e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura në mënyrë indirekte:

- Total TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin VMRO nr. 3, Qendër, Shkup, e cila merret me shpërndarjen e përmbajtjeve mediatike përmes platformave teknike të DTH,
- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në Orce Nikolov 68/3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitete të marketingut, gjegjësisht me blerje dhe shitje të hapësirës reklamuese në media të shkruara dhe elektronike, dhe
- UGI FIBER shpknpj Shkup, me seli në Bul. Partizanski odredi nr. 14, Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor.

Gjithashtu, në territorin e Maqedonisë së Veriut, BC Partners, përmes Junajted Grup, janë të pranishëm duke ofruar shërbimet e mëposhtme:

- Kanalet televizive të transmetuara nga persona të lidhur, pra të ritransmetuara nga operatorët lokalë, duke përfshirë N1, Grand, Cinemania, Sport Klub, Fight Channel, Pikaboo, Vavoom, IDJTV, Lov i Ribolov, Brainz, Nova S, etj. (Junajted Media (United Media));
- shërbime reklamimi (Direkt Media (Direct Media), Kas Media (Cas Media));
- shërbimet e telekomunikacionit (TOTAL TV SHPK Shkup; të ardhurat minimale në tregun vendor i realizon Serbia Broadband – Srpske kablovske mreže d.o.o. Beograd (Serbia Broadband – Srpske kablovske mreže d.o.o. Beograd) dhe Telemah d.o.o. Lublana (Telemach d.o.o. Ljubljana)).

**Shoqëria e telekomunikacionit KTV Dravograd d.o.o** përfaqëson një operator telekomunikacioni që është aktiv ekskluzivisht në Republikën e Sllovenisë dhe atë në territorin e qytetit të Dravogradit, duke u ofruar përdoruesve të saj shërbime të telefonisë fikse, qasje në internet me brez të gjerë (kabllo dhe optik), si dhe shpërndarja e përmbajtjes mediatike.

**Shoqëria e telekomunikacionit KTV Dravograd d.o.o** nuk është e pranishme dhe nuk gjeneron asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut.

**Shoqëria për informatikë dhe shërbime NAKOM d.o.o.** është një kompani që merret me ofrimin e shërbimeve të TI-së, kryesisht shërbime mbështetëse të TI-së për operatorët e telekomunikacionit, gjegjësisht web host në internet, është aktive ekskluzivisht në Republikën e Sllovenisë.

Shoqëria për informatikë dhe shërbime NAKOM d.o.o. nuk është e pranishme dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**